

L I G J^{1/2/3}
Nr. 9121, datë 28.7.2003

PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

Në mbështetje të neneve 11 pika 1, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për:

- a) ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg;
- b) të gjitha subjektet e përcaktuara në këtë pikë, që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për ato që e ushtrojnë veprimtarinë jashtë këtij territori, nëse pasojat e kësaj veprimtarie ndihen në tregun e brendshëm.
- c)⁴ ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta

¹ Ky ligj është përditësuar me ndryshimet e bëra me: Ligjin Nr. 9499 datë 03. 04. 2006 “Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe Ligjin Nr. 9584 datë 17. 07. 2006 “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të Tjera të Pavarura, të Krijuara me Ligj”, Ligjin Nr. 10 317 datë 16.09.2010 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të Ndryshuar”.

² Ligji Nr. 10 317 datë 16.09.2010 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, është publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 135 datë 07.10.2010. Ky Ligj hyn në fuqi në datën 23. 10.2010.

³ **KUJDES:** Përditësimi i këtij Ligji, është bërë vetëm për qëllime pune, për të lehtësuar punën e punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës në zbatimin e këtij ligji. Për qëllime zyrtare, referimet bëhen vetëm në botimin e ligjit në Fletoren Zyrtare. (Ligj Nr 9121 Datë 28-07-2003, Fletorja Zyrtare: Viti 2003, Nr 71, Faqe 3189; Ligj Nr 9499 Datë 03-04-2006, Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr 37 , Faqe 1160; Ligji Nr. 9584, datë 17.7.2006, Fletorja Zyrtare: Viti 2006, Nr 84 , Faqe 2841, Ligji Nr. 10 317 datë 16. 09.2010 Fletorja Zyrtare e vitit 2010 Nr. 135).

ekskluzive ose të drejta të veçanta;

ç)⁵ ndërmarrjet, të cilave u është dhënë e drejta e ushtrimit të veprimtarisë në fushën e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm apo ato, të cilat kanë karakterin e monopoleve të orientuara drejt sigurimit të të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që në ligj dhe në fakt nuk pengohet veprimtaria e tyre.”.

2. Ky ligj nuk zbatohet për marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësve e punëmarrësve dhe për marrëdhëniet që janë objekt i një kontrate kolektive ndërmjet punëdhënësve dhe sindikatave.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ndërmarrje" është çdo person fizik ose juridik, privat a publik, që kryen veprimtari ekonomike. Si ndërmarrje konsiderohen edhe organet e administratës qendrore e vendore, si dhe entet ose institucionet publike, kur kryejnë veprimtari ekonomike.

2. "Grupime ndërmarrjesh" janë grupimet e ndërmarrjeve të çdo forme, ligjore a faktike, që janë ose jo person juridik, privat a publik, me qëllim fitimprurës ose jo, të cilat mbrojnë interesat e ndërmarrjeve anëtare.

3. "Veprimtari ekonomike" është veprimtaria prodhuese, tregtare, financiare ose profesionale, që shoqërohet me blerjen dhe shitjen e mallrave dhe/ose me ofrimin apo përfitimn e shërbimeve.

4.⁶ "Marrëveshje" janë marrëveshjet dhe/ose praktikat e bashkërenduara ndërmjet dy apo më shumë ndërmarrjeve, si dhe vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, pavarësisht nga forma, e shkruar ose jo, apo nga forca detyruese e tyre.

5.⁷ "Pozitë dominuese" është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

6. "Produkt" është çdo mall, i shitur ose i blerë, ose çdo shërbim i ofruar apo i përfutur në treg nga ndërmarrjet.

7. "Treg përkatës" janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.

⁴ Pika "c" e nenit 2 të Ligjit shtuar me nenin 1 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010

⁵ Pika "ç" e nenit 2 të Ligjit, shtuar me nenin 1 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010

⁶ Pika "4" e nenit 3 të Ligjit, ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 10317 datë 16.09.2010. Ishte: *"Marrëveshje" janë marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, pra marrëveshje horizontale ose në nivele të ndryshme, pra marrëveshje vertikale, të tregut"*

⁷ Pika "5" e nenit 3 të Ligjit, ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: *"Pozitë dominuese" është pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët.*

8. "Autoriteti i Konkurrencës", që më poshtë do të quhet Autoriteti, është struktura e ngarkuar me kontrollin e zbatimit të këtij ligji.

9. "Komisioni i Konkurrencës", që më poshtë do të quhet Komisioni, është struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës.

PJESA II KUFIZIMET E KONKURRENCËS

KREU I MARRËVESHJET

Neni 4

Marrëveshjet e ndaluara

1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:

a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;

b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;

c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

ç)⁸ në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;

d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

2. Marrëveshjet që ndalohen, sipas pikës 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas neneve 5, 6 dhe 7, janë të pavlefshme.

⁸ Përmbajtja e gërnës “ç” të nenit 4 ndryshuar me nenin 3 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010. Ishte: “zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence”

Neni 5⁹

Përrjashtimi individual i marrëveshjeve

Mund të përjashtohet nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 çdo marrëveshje, e cila kontribuon në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik, nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve e të konsumatorëve dhe kur:

1. Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;
2. Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.

Neni 6¹⁰

Përrjashtimi i kategorive të marrëveshjeve

Komisioni miraton rregullore për kategoritë e marrëveshjeve që përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 4. Në këto rregullore përcaktohen me hollësi kushtet që duhet të përmbushin marrëveshjet, për të përfituar nga përjashtimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 4.

⁹ Neni 5 ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 4 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte:

Përrjashtimi i marrëveshjeve horizontale

1. Marrëveshjet horizontale, veçanërisht marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë racionalizimin ose specializimin e veprimtarisë ekonomike, kërkimin dhe zhvillimin e produkteve ose proceseve, blerjen ose shitjen e përbashkët të produkteve nga dhe te një burim i vetëm, mund të përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4, për shkak të efiçencës ekonomike.

2. Marrëveshjet justifikohen për shkak të efiçencës ekonomike nëse plotësohen këto kushte:

a) ulja e kostos së prodhimit ose të shpërndarjes, rritja e rendimentit, përmirësimi i produkteve ose proceseve të prodhimit, nxitja e kërkimit për zhvillimin dhe përhapjen e njohurive teknike e profesionale, shfrytëzimi i burimeve në mënyrë më racionale ose nxitja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, rezultate këto që nuk mund të arrihen ndryshe;

b) pjesëmarrja më e drejtë në këtë përfitim nga ana e konsumatorëve ose e përdoruesve;

c) moskufizimi i ndjeshëm i konkurrencës.

¹⁰ Neni 6 ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 5 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Përrjashtimi i marrëveshjeve vertikale

1. Marrëveshjet vertikale mund të përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të këtij ligji, për shkak të efiçencës ekonomike, veçanërisht kur kanë si objekt ose si pasojë:

a) kufizimin e shitjeve me kontakte të drejtpërdrejta brenda një territori ekskluziv ose ndaj një grupi klientësh ekskluzivë, të rezervuar për vetë furnizuesin ose për një shpërndarës tjetër të autorizuar nga furnizuesi, nëse një marrëveshje e tillë nuk kufizon shitjet e klientëve të shpërndarësit;

b) kufizimin e shitjeve përdoruesve të fundit nga shpërndarësi, që vepron në nivelin e tregtisë me shumicë;

c) kufizimin e shitjeve shpërndarësve të paautorizuar nga anëtarët e një sistemi shpërndarjeje, në të cilin ndërmarrjet furnizuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, u shesin produktet e kontraktuara shpërndarësve të përzgjedhur në bazë të kriterëve të caktuara;

ç) kufizimin e së drejtës të shpërndarësve për t'u shitur pjesë përbërëse klientëve, të cilët i përdorin ato për prodhimin e produkteve të ngjashme me ato të furnizuesit.

2. Parashikimet e nenit 5 pika 2 të këtij ligji zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni.

Neni 7¹¹

Marrëveshjet me rëndësi të vogël

Mund të përjashtohen nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 ato marrëveshje, të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën në treg, në rast se pjesa e tregut e të gjitha ndërmarrjeve së bashku, pjesëmarrëse në këtë marrëveshje, nuk tejkalon:

- a) 10 për qind të tregut përkatës, ku pjesëmarrësit janë konkurrentë aktualë ose potencialë;
- b) 15 për qind të tregut përkatës, ku pjesëmarrësit nuk janë konkurrentë aktualë ose potencialë.

KREU II ABUZIMI ME POZITËN DOMINUESE

Neni 8

Vlerësimi i pozitës dominuese

Pozita dominuese e një ose më shumë ndërmarrjeve vlerësohet, duke marrë parasysh, veçanërisht:

- a) pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë;
- b) pengesat në hyrje në tregun përkatës;
- c) konkurrencën potenciale;
- ç) fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve;
- d) varësinë ekonomike të furnizuesve dhe blerësve;

¹¹ Neni 7 ndryshuar në përmbajtje dhe titull, me nenin 6 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Përjashtimi i marrëveshjeve të licencës

1. Marrëveshjet e licencës dhe të shitjes së të drejtave të pronësisë industriale mund të përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të këtij ligji nëse:

a) liria tregtare e blerësit, e të licencuarit ose e ndërmarrjeve të tjera nuk kufizohet pa të drejtë dhe

b) konkurrenca në treg nuk kufizohet ndjeshëm.

2. Nuk ndalohen, sipas nenit 4, angazhimet që kufizojnë blerësin ose të licencuarin, për aq kohë sa këto kufizime nuk tejkalojnë periudhën e së drejtës së blerë ose të së drejtës që përbën objektin e licencës, në mënyrë të veçantë kur:

a) justifikohen nga interesat e shitësit ose të licencuesit për një shfrytëzim teknik sa më të mirë të objektit të së drejtës së mbrojtur;

b) vendosin detyrimin për të shkëmbyer përvojë ose për të dhënë licenca joekskluzive për shpikje, për përmirësimet ose zbatimin e këtyre të fundit, me kusht që këto detyrime të jenë të njëjta për shitësin dhe licencuesin;

c) kanë si objekt moskundërshtimin e së drejtës së mbrojtur;

ç) çojnë në një përdorim minimal të së drejtës së mbrojtur që është objekt i licencës ose në pagesën e një tarife minimale;

d) etiketojnë produktet e licencuara, duke mos përjashtuar referencën e prodhuesit.

- dh) fuqinë kundërvepruese të blerësve;
- e) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve;
- ë) lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera;
- f) karakteristika të tjera të tregut përkatës si: homogjenitetin e produkteve, transparencën e tregut, uniformitetin e kostos dhe të madhësisë së ndërmarrjeve, qëndrueshmërinë e kërkesës ose të kapaciteteve të lira prodhuese.

Neni 9¹²

Abuzimi me pozitën dominuese në treg

1. Ndalohet çdo abuzim me pozitën dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje, që e zotërojnë këtë pozitë në treg.
2. Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese veçanërisht:
 - a) vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - b) kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c) zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - ç) vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

¹² Neni 9 ndryshuar në titull dhe përmbajtje me nenin 7 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte:

Abuzimi me pozitën dominuese në treg

1. Ndalohet çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese në treg.
2. Mund të përbëjnë abuzim veçanërisht:
 - a) vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta blerjeje ose shitjeje, ose e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - b) kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c) zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - ç) lidhja e kontratave, me kusht që palët e tjera kontraktuese të pranojnë detyrime shtesë;
 - d) vendosja e çmimeve ose e kushteve të tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjen jashtë tregut përkatës të konkurrentëve të veçantë a të një produkti të tyre;
 - dh) refuzimi për të tregtuar ose për të dhënë licenca;
 - e) refuzimi i hyrjes së një ndërmarrjeje tjetër, kundrejt një shpërblimi të përshtatshëm, në rrjetin ose në infrastrukturat e ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëse ky refuzim i përdorimit të njëkohshëm të rrjetit ose të infrastrukturave pengon ndërmarrjen tjetër të veprave si konkurrent i ndërmarrjes me pozitë dominuese.
3. Nuk konsiderohen abuzive praktikatat e një ose më shumë ndërmarrjeve me pozitë dominuese në treg, nëse këto ndërmarrje provojnë se i kanë kryer për arsye objektive, siç mund të jenë arsyet teknike ose arsyet e ligjshme tregtare.

KREU III
PËRQENDRIMET E NDËRMARRJEVE

Neni 10¹³

Përqendrimi i ndërmarrjeve

1. Përqendrim të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit, si rrjedhojë e:

a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra;

b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm;

c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjesë të këtyre të fundit.

2. Kontrolli, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, mund të përfitohet nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat, më vete ose të kombinuara dhe, duke marrë parasysh rrethanat e faktit ose të ligjit, krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje, në veçanti, me anë të:

a) së drejtës së pronës ose të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje;

b) të drejtave ose kontratave, që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje.

3. Krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët nuk përbën një përqendrim, sipas këtij neni, në rast se ka për objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura. Në këtë rast, krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët vlerësohet në bazë të nenit 4 të këtij ligji.”

¹³ Neni 10 ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 8 të Ligjit Nr. 10 317. Ishte:

Përqendrimi i ndërmarrjeve

1. Përqendrim të ndërmarrjeve kemi në rastet e mëposhtme:

a) kur bashkohen dy ose më shumë ndërmarrje ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra;

b) në çdo transaksion, nëpërmjet të cilit një ose më shumë ndërmarrje përftojnë kontroll, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një ose më shumë ndërmarrjeve ose të një pjesë të këtyre të fundit;

c) kur krijohet një ndërmarrje e përbashkët, që kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur.

2. Kontrolli, sipas pikës 1 shkronja “b” të këtij neni, mund të vendoset nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat, në mënyrë të veçantë ose të kombinuar, në bazë juridike ose faktike, krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje, në veçanti me anë të:

a) së drejtës së pronës ose të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje;

b) të drejtave ose kontratave, që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje.

Neni 11
Blerja e aksioneve për rishitje

Nuk konsiderohet përqendrim blerja e aksioneve të një ndërmarrjeje nga institucionet financiare, institucionet e kreditit dhe të sigurimit, për rishitje, për sa kohë që ato nuk ushtrojnë të drejtën e votës për aksionet që kanë dhe me kusht që rishitja e tyre të bëhet brenda një viti nga blerja.

Neni 12¹⁴
Kontrolli i përqendrimeve

1. Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet për të marrë autorizim, nëse, në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:

a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.

2. Përqendrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni njoftohen brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim, për përftim kontrolli ose për krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët, me karakteristikat e parashikuara në pikën 3 të nenit 10 të ligjit, si dhe nga publikimi i ofertës publike për blerje ose shkëmbim.

3. Ndërmarrje pjesëmarrëse, në kuptimin e këtij neni, janë:

a) në rast bashkimi, ndërmarrjet që bashkohen;

b) në rast përftimi kontrolli, ndërmarrjet dhe/ose personat e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 10, që përftojnë kontrollin, dhe ndërmarrjet ose pjesët e ndërmarrjeve, që bëhen objekt të përftimit të kontrollit;

¹⁴ Neni 12, ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 9 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010. Ishte:

Kontrolli i përqendrimeve

1. Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:

a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar, është më shumë se 70 miliardë lekë, ose xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun e brendshëm, është më shumë se 800 milionë lekë dhe

b) xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 500 milionë lekë.

2. Përqendrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni njoftohen brenda një jave nga lidhja e marrëveshjes për bashkim ose për përftim kontrolli, si dhe nga publikimi i ofertës publike për blerje ose shkëmbim.

3. Ndërmarrje pjesëmarrëse, në kuptimin e këtij neni, janë:

a) në rast bashkimi, ndërmarrjet që bashkohen;

b) në rast përftimi kontrolli, ndërmarrjet që përftojnë kontrollin dhe ato që bëhen objekt të përftimit të kontrollit;

c) pjesa e ndërmarrjes, në rast se transaksioni prek këtë të fundit.

c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Neni 13¹⁵

Vlerësimi i përqendrimit

1. Komisioni ndalon përqendrimet e ndërmarrjeve, që kufizojnë, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

2. Komisioni, në vlerësimin e përqendrimeve, mund të marrë, gjithashtu, parasysh, eficientat ekonomike që mund të rrjedhin nga përqendrimi, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) eficientat në fjalë kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së konsumatorëve ose, të paktën, neutralizojnë efektet e mundshme negative që mund të sillte përqendrimi;

b) eficientat ekonomike janë ose do të jenë rezultat i përqendrimit nën shqyrtim dhe, për krijimin e tyre, nuk ekzistojnë mënyra alternative më pak antikonkurruese, se përqendrimi në fjalë;

c) eficientat ekonomike duhet të jenë të verifikueshme.

3. Komisioni, në raste të veçanta, mund të mos ndalojë përqendrimet, kur njëra nga ndërmarrjet pjesëmarrëse rrezikon seriozisht të falimentojë e nuk ka mundësi tjetër më pak antikonkurruese se realizimi i përqendrimit nëse:

a) ndërmarrja ndodhet në një situatë të tillë që, pa këtë përqendrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt;

b) nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje.

Neni 14

Ndalimi i realizimit të përqendrimit

1. Përqendrimet, sipas nenit 10 të këtij ligji, nuk realizohen sipas rastit:

a) përpara njoftimit në autoritet;

b) përpara marrjes së autorizimit nga Autoriteti,

c) kur nuk janë plotësuar kushtet e vendosura në autorizim.

2. Veprimet ligjore ose kontraktore, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, janë të pavlefshme, përveç rastit kur jepet një autorizim për realizim të përkohshëm, sipas

¹⁵ Neni 13, ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 10 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010. Ishte:

Vlerësimi i përqendrimit

1. Komisioni ndalon përqendrimet e ndërmarrjeve, që rrezikojnë të krijojnë ose të forcojnë pozitën dominuese të një ose të më shumë ndërmarrjeve.

2. Komisioni nuk ndalon përqendrimet, kur njëra nga ndërmarrjet pjesëmarrëse rrezikon seriozisht të falimentojë dhe nuk ka mundësi tjetër më pak antikonkurruese se realizimi i përqendrimit nëse:

a) ndërmarrja ndodhet në një situatë të tillë që, pa këtë përqendrim, duhet të dalë nga tregu në një të ardhme të afërt;

b) nuk ka mundësi për riorganizimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrjeje.

nenit 60 të këtij ligji.

Neni 15

Llogaritja e xhiros

1. Xhiroja totale përbëhet nga shuma e përftuar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse prej shitjes së produkteve në të gjithë veprimtarinë e zakonshme të ndërmarrjeve, gjatë vitit financiar paraardhës, pas zbritjes së tatimeve, taksave dhe tarifave të tjera që lidhen drejtpërdrejt me xhiron e ndërmarrjeve.

2. Kur përqendrimi ka të bëjë me blerjen e pjesëve të një ose të më shumë ndërmarrjeve, që janë ose jo persona juridikë, për shitësin ose shitësat merret parasysh vetëm xhiroja për pjesët që janë objekt i transaksionit.

3. Dy ose më shumë transaksione, sipas kuptimit të pikës 2 të këtij neni, të cilat kryhen ndërmjet të njëjtave ndërmarrje, brenda një periudhe dyvjeçare, vlerësohen si një përqendrim i vetëm. Për të përcaktuar periudhën dyvjeçare, fillohet nga data e transaksionit të fundit.

Neni 16

Xhiroja e ndërmarrjeve pjesëmarrëse që janë pjesë të një grupi

1. Kur ndërmarrja pjesëmarrëse bën pjesë në një grup ndërmarrjesh, xhiroja totale e ndërmarrjes pjesëmarrëse, sipas nenit 15 të këtij ligji, llogaritet duke mbledhur xhirot:

a) e vetë ndërmarrjes pjesëmarrëse;

b) e ndërmarrjeve filiale, në të cilat ndërmarrja pjesëmarrëse, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, zotëron më shumë se gjysmën e kapitalit ose më shumë se gjysmën e votave, ose ka fuqinë të emërojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, të këshillit administrativ ose të strukturave të tjera ligjore, që përfaqësojnë ndërmarrjen, ose ka të drejtë të drejtojë çështjet e ndërmarrjes;

c) e ndërmarrjeve mëmë, që në ndërmarrjen pjesëmarrëse kanë të drejta ose fuqi të përcaktuara në shkronjën "b" të këtij neni;

ç) e ndërmarrjeve filiale simotra ose filiale të ndërmarrjes mëmë, në të cilat një ndërmarrje, sipas shkronjës "c" të kësaj pike, ka të drejta ose fuqi të përcaktuara në shkronjën "b";

d) të ndërmarrjeve, në të cilat dy ose më shumë ndërmarrje, sipas shkronjave "a", "b", "c" dhe "ç" të kësaj pike, kanë bashkërisht të drejta ose fuqi, sipas përcaktimit të shkronjës "b".

2. Në xhiron totale të ndërmarrjes pjesëmarrëse nuk përfshihet shitja e produkteve ndërmjet ndërmarrjeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur ndërmarrjet pjesëmarrëse kanë bashkërisht të drejta dhe fuqi të përcaktuara në pikën 1 shkronja "b" të këtij neni, në llogaritjen e xhiros totale:

a) nuk merret parasysh xhiroja që rezulton nga shitja e produkteve, ndërmjet ndërmarrjes së përbashkët dhe secilës prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse, si dhe çdo ndërmarrjeje tjetër, sipas pikës 1 shkronjat "b" deri në "d" të këtij neni;

b) merret parasysh xhiroja e rezultuar nga shitja e produkteve ndërmjet ndërmarrjes së bashkuar dhe palëve të treta, e cila ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet ndërmarrjeve pjesëmarrëse.

Neni 17

Xhiroja e institucioneve të kreditit, institucioneve të tjera financiare dhe ndërmarrjeve të sigurimit

1. Për institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare, në vend të xhiros së parashikuar në nenin 15 pika 1 të këtij ligji, përdoret shuma që rezulton në llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të bankave dhe të institucioneve të tjera financiare, nga të ardhurat e elementeve të mëposhtme, pas zbritjes së tatimeve, që lidhen drejtpërdrejt me këto elemente:

- a) të ardhurat nga interesi dhe të ardhura të tjera të ngjashme;
- b) të ardhurat nga aksionet, nga letra me vlerë me normë interesi të ndryshueshme, si dhe nga interesat e pjesëmarrjeve në kapital;
- c) të ardhurat nga komisione të arkëtueshme;
- ç) fitimi neto nga operacione financiare;
- d) të ardhurat nga veprime të tjera.

2. Për ndërmarrjet e sigurimit, në vend të xhiros së parashikuar në nen 15 në pikën 1, përdoret vlera bruto e primeve të nënshkruara, të cilat përfshijnë të gjitha shumat e marra dhe të arkëtueshme, në bazë të kontratave të sigurimit, të lëshuara nga ose në emër të shoqërive të sigurimit, përfshirë edhe primet e risigurimit, pas zbritjes së tatimeve, që lidhen drejtpërdrejt me elementet e mësipërme.

3. Parashikimet e nenit 15 pikat 2 e 3, si dhe të nenit 16 zbatohen edhe për pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

PJESA III

AUTORITETI I KONKURENCËS DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

KREU I

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETIT TË KONKURENCËS

Neni 18

Autoriteti i Konkurrencës

1. Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta. Autoriteti është person juridik, me seli në Tiranë.

2. Autoriteti përbëhet nga Komisioni dhe nga Sekretariati.

Neni 19

Komisioni i Konkurrencës

Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Ai vepron si një organ kolegjal i përhershëm.

Neni 20

Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit

Anëtar i Komisionit mund të zgjidhet kandidati që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë vjetërsi pune në profesion jo më pak se 15 vjet;
- c) të jetë, prej jo më pak se 5 vjetësh, pjesëtar i trupit akademik universitar ose të mbajë titull apo gradë shkencore në fushën e ekonomisë a të drejtësisë, specialiteti "E drejtë civile/ administrative" ¹⁶;
- ç) të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.

Neni 21

Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit

1. Anëtarët e Komisionit zgjidhen me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për një periudhë 5-vjeçare. Kuvendi emëron Kryetarin e Komisionit. Zëvendëskryetari zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, në mbledhjen e parë të Komisionit.

2. Anëtarët e Komisionit zgjidhen jo më shumë se dy mandate radhazi. Vetëm për herën e parë të zgjedhjes, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Kryetari ka një mandat 5-vjeçar, Zëvendëskryetari mandat 4-vjeçar dhe tre anëtarët e tjerë kanë mandat 3-vjeçar.

3. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Kuvendi, me kandidatura alternative, si më poshtë:

- a) një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës;
- b) dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave;
- c) dy anëtarë propozohen nga Kuvendi.

4. Paga e anëtarëve të Komisionit vendoset nga Kuvendi.

3/1¹⁷. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtari të komisionit, autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikën për zgjedhjen e anëtarit të ri. Në rastet kur mandati i anëtarit të komisionit ka përfunduar dhe nuk është realizuar emërimi i anëtarit të ri, anëtari i vjetër qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij.

Neni 22

Papajtueshmëritë dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të Komisionit

1. Nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit personat që bëjnë pjesë në organet e larta drejtuese të partive politike, anëtarët e organeve drejtuese të shoqërive tregtare ose personat që ushtrojnë veprimtari ekonomike.

2. Anëtari i Komisionit zëvendësohet:

- a) pas mbarimit të mandatit;

¹⁶ Shkronja "c" e nenit 20 të këtij ligji është ndryshuar me nenin 1 të Ligjit Nr. 9499 datë 03. 04. 2006. Para këtij ndryshimi ishte: "të jetë i njohur për kontributin në fushën e shkencave ekonomike dhe juridike ose për aftësitë drejtuese dhe profesionalitetin e shfaqur në sektorë të ndryshëm të ekonomisë"

¹⁷ Pika "3/1" e nenit 21 shtuar me nenin 11 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010.

- b) kur largohet nga detyra, sipas pikës 3 të këtij neni;
- c) kur vdes;
- ç) kur jep dorëheqjen;
- d) kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

dh) kur nga gjykata është ndaluar ose pezulluar të ushtrojë detyrën si nëpunës civil ose funksion tjetër në shërbimin publik ose të ushtrojë detyra drejtuese pranë personave juridikë.

3. Anëtari i Komisionit largohet nga detyra me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, kur:

- a) ka shkëlur rëndë ligjin dhe etikën e punës gjatë kryerjes së detyrës;
- b) është në pamundësi fizike ose mendore për të ushtruar detyrën,
- c)¹⁸ mungon në detyrë mbi 1 muaj në mënyrë të pajustificuar;
- ç) humbet shtetësinë shqiptare.

Neni 23

Konflikti i interesave

Kryetari, Zëvendëskryetari ose çdo anëtar tjetër i Komisionit nuk merr pjesë në shqyrtimin e një çështjeje për të cilën ai ka interes ose kur ka përfaqësuar njërin nga palët pjesëmarrëse. Në këtë rast, Komisioni e merr vendimin në mungesë të Kryetarit, Zëvendëskryetarit ose anëtarit në fjalë.

Neni 24

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) harton politikën kombëtare të konkurrencës;
- b) *(shfuqizuar)*¹⁹;
- c) miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të Autoritetit;
- ç) mbikëqyr punën e Sekretariatit për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- d) merr vendime sipas këtij ligji;
- dh) nxjerr rregullore dhe udhëzime në zbatim të këtij ligji;
- e) brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës paraqet në Kuvend raportin vjetor të Autoritetit;
- ë) me kërkesën e komisioneve të Kuvendit, jep vlerësime për çështje që lidhen me konkurrencën dhe legjislacionin në këtë fushë;
- f) u jep vlerësime dhe rekomandime organeve të administratës qendrore e vendore dhe institucioneve të tjera publike, shoqatave tregtare, sindikatave, shoqatave të konsumatorit, dhomave të tregtisë dhe të industrisë, për çështjet që lidhen me konkurrencën;
- g) përfaqëson Autoritetin, brenda dhe jashtë vendit, në marrëdhëniet me

¹⁸ Shkronja “c” e pikës 3 të nenit 22 të këtij ligji, ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr. 9499 datë 03. 04. 2006. Para këtij ndryshimi ishte: “*mungon në detyrë për më shumë se tre muaj në mënyrë të pajustificuar*”.

¹⁹ Pika “b” e nenit 24 të këtij ligji, shfuqizuar me nenin 15 të Ligjit Nr. 9548 datë 17. 07. 2006. Para këtij shfuqizimi, ishte: “*miraton strukturën organizative dhe organikën e Sekretariatit*”

institucionet e tjera dhe ato simotra;

gj)²⁰ përcakton përparësitë e hetimeve dhe afatet përkatëse për to

Neni 25

Detyrat e Kryetarit

1. Kryetari i Komisionit ka këto detyra:
 - a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit;
 - b) bashkërendon punën ndërmjet anëtarëve të Komisionit;
 - c) nënshkruan aktet e Komisionit, me përjashtim të vendimeve, që nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.
 - ç) përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët;
2. Në mungesë të Kryetarit këto detyra kryhen nga Zëvendëskryetari.

Neni 26

Marrja e vendimeve

1. Marrja e vendimeve është e vlefshme kur në mbledhjen e Komisionit janë të pranishëm të paktën katër anëtarë, prej të cilëve njëri duhet të jetë Kryetari ose Zëvendëskryetari, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 23 të këtij ligji.
2. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rast barazimi të votave, vota e kryesuesit të mbledhjes është vendimtare. Abstenimi nuk lejohet.

Neni 27

Sekretariati i Konkurrencës

1. Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Komisioni.
2. Nëpunësit²¹ e Sekretariatit gëzojnë statusin e nëpunësit civil.
3. Inspektorët e Sekretariatit kryejnë hetime administrative, sipas Kodit të Procedurave Administrative, këtij ligji dhe legjisllacionit tjetër në fuqi.

Neni 28

Përgjegjësitë e Sekretariatit

Sekretariati, për ndjekjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, ka këto përgjegjësi:

- a) monitoron dhe analizon kushtet e tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive;
- b) kryen hetime, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, këtë ligj

²⁰ Gërma “gj” në nenin 24 shtuar me nenin 12 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

²¹ Në nenin 27, fjala “nëpunësit”, ka zëvendësuar fjalën “punonjësit”. Kjo, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010.

dhe legjislacionin në fuqi;

- c) harton dhe paraqet raportet e hetimit pranë Komisionit për vendimmarrje;
- ç) siguron publikimin e vendimeve të marra, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, si dhe të raportit vjetor të Autoritetit;
- d) ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të marra nga Komisioni.

Neni 29

Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Sekretariatit. Në mungesë të tij ose në pamundësi për të vepruar, me miratim të Komisionit, ai mund t'ia delegojë përgjegjësitë njërit prej drejtorëve të drejtorive të Sekretariatit.

2. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për:

- a) zbatimin e procedurave të këtij ligji për shqyrtimin e rasteve;
- b) hartimin dhe paraqitjen e raportit përmbledhës të hetimit para Komisionit për vendimmarrje;
- c) bashkërendimin e punës së drejtorive të Sekretariatit;
- ç) përgatitjen e raportit vjetor të punës së Autoritetit;
- d) bashkëpunimin me institucionet e tjera, brenda dhe jashtë vendit, për zgjidhjen e çështjeve;
- dh) nënshkrimin e korrespondencës shkresore të Sekretariatit.

Neni 29/1²²

Trajtimi i ankesave

Palë të treta ose të interesuara për çështje që lidhen me kufizime, shtrembërime ose pengime të konkurrencës, paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës ankesa a njoftime për këto konstatime. Autoriteti ruan dhe garanton mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e kushtëzon një gjë të tillë.

Ankesat ose njoftimet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes, pasi shënohen në regjistrin e protokollit, përcillen për trajtim profesional, brenda një afati të përcaktuar, në sekretariatit e Autoritetit. Procedurat e trajtimit të ankesave përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Autoritetit.”.

Neni 30

Ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekreteve tregtare

1. Anëtarët e Komisionit dhe të gjithë punonjësit e Sekretariatit ose personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni për zbatimin e këtij ligji ruajnë sekretin profesional dhe nuk u japin të dhëna konfidenciale, të siguruara gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur duhet të dëshmojnë përpara gjykatës. Kjo vlen dhe pas mbarimit të detyrës.

²² Neni 29/1 shtuar me nenin 14 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

2. Publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret tregtar.

Neni 31

Financimi i Autoritetit

1. Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit, miratohet nga Kuvendi.

2. Të ardhurat që krijohen në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe të ardhurat nga gjobat, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi.

3. Autoriteti mban llogari të shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

KREU II

PROCEDURAT E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Neni 32

Parimi i përgjithshëm

Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.

Neni 33

Detyrimi për të informuar

1²³. Në çdo kohë, Autoriteti, me anë të një kërkesë të sekretariatit ose të komisionit, mund t'u kërkojë të tretëve, ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve, t'i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme, për zbatimin e këtij ligji, përfshirë edhe ato, të cilat përmbajnë sekrete tregtare

2. Kur ndërmarrjet ose personat nuk japin të dhënat e kërkuara, ose japin të dhëna të paplota brenda periudhës së caktuar në kërkesën e Sekretariatit, ose kur Komisioni e vlerëson të nevojshme, ai i kërkon të dhënat nëpërmjet një vendimi.

3. Në kërkesën e Sekretariatit dhe vendimin e Komisionit përcaktohen baza ligjore, qëllimi, afati kohor, brenda të cilit duhet të sigurohen të dhënat, si dhe gjobat e parashikuara në ligj, në rast mospërmbushjeje të kërkesës ose vendimit.

4²⁴.(shfuqizuar)

²³ Pika "1" e nenit 33 ndryshuar me nenin 15 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte: "Ndërmarrjet që hetohen, ato që kërkojnë një përjashtim, ato që janë pjesëmarrëse në një përqendrim, si dhe ndërmarrjet ose personat e tjerë që mund të kenë të dhëna të vlefshme për trajtimin e një çështjeje, me kërkesë të Sekretariatit dhe në çdo fazë të procedurës së hetimit, janë të detyruara t'i japin këto të dhëna."

²⁴ Pika "4" e nenit 33 shfuqizuar me nenin 15 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010. Ishte: "Ndërmarrjet dhe personat, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, detyrohen të japin edhe të dhëna që përmbajnë sekrete tregtare"

Neni 34

Detyrimi për organet e administratës publike

Organet e administratës qendrore e vendore dhe institucionet e tjera publike bashkëpunojnë me Autoritetin për sigurimin e të dhënave dhe të provave të nevojshme.

Neni 35

Përgjegjësitë për inspektim

1. Sekretariati kryen inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve dhe grupimeve të ndërmarrjeve, sipas objektit dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj.

2. Komisioni, me kërkesën e Sekretariatit, autorizon me shkrim inspektorët e Sekretariatit për kryerjen e inspektimeve, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj. Për të kryer inspektimin, inspektorët e Autoritetit paraqesin autorizimin, i cili përmban objektin dhe qëllimin e inspektimit, si dhe sanksionet e parashikuara në nenet 73, 74, 76 dhe 78 të këtij ligji.

3. Autoriteti kërkon ndihmën e Policisë së Shtetit²⁵ në rastet kur pengohet kryerja e inspektimeve të nevojshme.

Neni 36

Inspektimi në ndërmarrje

Inspektorët e Sekretariatit dhe persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Komisioni për kryerjen e inspektimeve mund:

a) të hyjnë në mjediset, mjetet e transportit dhe në territorin e ndërmarrjeve, gjatë orarit të punës;

b) të shqyrtojnë librat dhe regjistrat e veprimtarisë ekonomike dhe dokumentet e tjera, pavarësisht nga mënyra e ruajtjes së këtij dokumentacioni, në formë të shkruar ose elektronike;

c) të marrin ose të sigurojnë kopje ose pjesë nga këto libra, regjistra ose dokumente;

ç) të vulosin çdo seli, libër ose regjistër të veprimtarisë ekonomike për jo më shumë se 72 orë, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për inspektimin;

d) t'i kërkojnë çdo përfaqësuesi ose punonjësi të ndërmarrjes shpjegime për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit.

Neni 37

Kontrolli në mjedise të tjera

1. Inspektorët e Autoritetit, të autorizuar me vendim nga gjykata që ka në juridiksion vendin ku kryhet kontrolli, mund të hyjnë:

a) në banesat e administratorëve, menaxherëve, drejtorëve dhe punonjësve të tjerë të ndërmarrjes, si dhe në banesat e selitë e veprimtarisë ekonomike të personave fizikë

²⁵ Në bazë të nenit 16 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010, emërtimi "Policisë Tatimore" është zëvendësuar me emërtimin "Policisë së Shtetit".

dhe juridikë, të brendshëm ose të jashtëm, të ngarkuar për menaxhimin tregtar, kontabël, administrativ, fiskal ose financiar nga ora 700 deri në orën 1800 ;

b) në mjedise të tjera, të njësuara me banesat, kur ka arsye të bazuara për fakte dhe rrethana konkrete se në këto mjedise gjenden ditare ose dokumente të tjera profesionale, që mund të jenë të nevojshme për të vërtetuar shkeljet e neneve 4 dhe 9 të këtij ligji.

2. Inspektorët e Sekretariatit, të autorizuar me vendim të Komisionit për kryerjen e kontrollit, vepronë sipas nenit 36 shkronjat "a", "b", "c" dhe "d" dhe nenit 38 të këtij ligji.

Neni 38 **Sekuestrimi**

1. Inspektorët e Autoritetit sekuestrojnë objekte që kanë vlerën e provës materiale në hetim, për jo më shumë se 72 orë, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme. Personi që preket nga sekuestrimi njoftohet për këtë pa vonesë.

2. Gjykata që ka në juridiksion vendin ku ndodh sekuestrimi, me kërkesë të Autoritetit, mund ta zgjasë afatin e mbajtjes në sekuestro, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, por jo më shumë se 6 muaj.

3. Inspektorët hartojnë një procesverbal për sekuestrimin, një kopje e të cilit i jepet personit të interesuar. Ky person vihet në dijeni për të drejtën e ankimit në gjykatë.

Neni 39 **E drejta e palëve për t'u dëgjuar**

Ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve kanë të drejtë të shprehen për çështjen, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni. Komisioni e bazon vendimin vetëm në pretendime, për të cilat palëve u është dhënë mundësia për t'u shprehur.

Neni 40 **Ankimi ndaj vendimeve**

1. Kundër vendimeve të Autoritetit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.

2. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimeve që autorizojnë përqendrimet dhe marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44 të këtij ligji.

3. Gjykata e Tiranës mund të vendosë pezullimin, tërësisht ose pjesërisht, të këtyre masave.

KREU III
PROCEDURAT PËR MARRËVESHJET DHE PËR ABUZIMIN E POZITËS
DOMINUESE

SEKSIONI I
PROCEDURAT PËR HETIMET

Neni 41²⁶

1. Autoriteti, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatore të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera të bëjnë të mendosh se konkurrenca në treg kufizohet ose shtrembërohet.

2. Autoriteti mund t'u kërkojë ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve që t'i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e hetimit.

3. Autoriteti mund të publikojë një raport për rezultatet e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, si dhe mund të ftojë palët e interesuara të shprehen për rezultatet e hetimit.

4. Parashikimet e neneve 33 e 34 të këtij ligji zbatohen edhe për pikën 2 të këtij neni.

Neni 42²⁷

Hetimi paraprak

1. Sekretariati, me miratimin e komisionit, mund të fillojë hetimin paraprak, me nismën e tij, me ankesë të palëve të interesuara ose të treta, për kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës. Sekretariati fillon hetimin paraprak, sa herë që kërkohet nga komisioni.

2. Gjatë hetimit paraprak nuk nënkuptohet e drejta për të konsultuar dosjet.

3. Autoriteti ruan mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e paracakton një gjë të tillë.

²⁶ Neni 41, ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 17 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Hetimi në sektorët e ekonomisë

Autoriteti, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit dhe me kërkesën e institucioneve rregullatore të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera të bëjnë të mendosh se konkurrenca në treg kufizohet ose shtrembërohet.

²⁷ Neni 42 ndryshuar në titull dhe përmbajtje me nenin 18 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Procedurat e hetimit paraprak

1. Sekretariati mund të fillojë procedurën paraprake të hetimit, me nismën e tij, me kërkesën e ndërmarrjeve të interesuara ose në bazë të një ankese të të tretëve. Ai fillon një procedurë të tillë çdo herë që kërkohet nga Komisioni. Procedurat paraprake të hetimit kryhen sipas Rregullores së Funkcionimit të Autoritetit.

2. Procedura e hetimit paraprak nuk nënkupton të drejtën për të konsultuar dosjet.

Neni 43²⁸
Hetimi i thelluar

1. Kur vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës, fillohet procedura e hetimit të thelluar. Komisioni merr vendim për fillimin e procedurës së hetimit të thelluar dhe përcakton hapat për realizimin e tij. Vendimi zbatohet nga sekretariati i komisionit.

2. Afati i përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar është deri në 6 muaj nga data e vendimit të komisionit për hapjen e hetimit të thelluar.

3. Afati, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të komisionit, në rast se kërkohen hetime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.

4. Procedurat hetimore, të parashikuara në nenet 41, 42 e 43 të këtij ligji, kryhen sipas rregulloreve të dala në zbatim të këtij ligji.

5. Komisioni shprehet me vendim për mbylljen e hetimit, në zbatim të neneve 41, 42, e 43 të këtij ligji, edhe në rastet kur nuk konstatohen shenja të kufizimeve të konkurrencës.

Neni 44
Masa të përkohshme

1. Në rast urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, Komisioni, me nismën e tij, ose në bazë të një kërkesë nga palët e interesuara dhe në çdo kohë të procedurës, mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme, të përcaktuara në nenin 61 shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “dh” të këtij ligji.

2. Vendimi, në mbështetje të pikës 1 të këtij neni, merret për një kohë të caktuar dhe mund të shtyhet në rast nevojë.

Neni 45
Vendimet e Komisionit

1. Kur Komisioni vëren shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, ai, me vendim, detyron ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve të interesuara të ndalojnë këto shkelje. Për ndalimin e shkeljes Komisioni mund të kërkojë nga ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve të interesuara të marrin masat e nevojshme, përfshirë dhe ato strukturore. Në bazë të parimit të proporcionalitetit, masat strukturore parashikohen kur masat për të vepruar ose për të mos vepruar në një mënyrë të caktuar nuk janë efikase.

2. Kur ndërmarrjet e interesuara marrin angazhime në përgjigje të vërejtjeve të bëra nga Autoriteti në vlerësimin paraprak, i cili u është komunikuar ndërmarrjeve, Komisioni, me vendim, mund t'i përcaktojë ato të detyrueshme për ndërmarrjet, në

²⁸ Neni 43 ndryshuar në titull dhe përmbajtje me nenin 19 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Procedurat e thelluara të hetimit

1. Kur vihen re shenja të kufizimeve të konkurrencës, Sekretariati, me miratim të Komisionit, fillon një procedurë të thelluar hetimi. Ai fillon një procedurë të tillë sa herë që i kërkohet nga Komisioni.

2. Komisioni përcakton radhën e kryerjes së hetimeve, sipas Rregullores së Funkcionimit të Autoritetit.

formën e kushteve dhe të detyrimeve.

Neni 46

Revokimi i vendimeve

Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:

- a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
- b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
- c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Neni 47

Publikimi i fillimit të hetimit dhe i vendimeve

1. Autoriteti publikon fillimin e hetimit të thelluar në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Në njoftim përcaktohen qëllimi i hetimit, argumentet për fillimin e hetimit dhe palët që hetohen. Autoriteti, nëpërmjet njoftimit, fton edhe palë të treta të marrin pjesë në hetim, nëse ato janë të interesuara. Mungesa e publikimit nuk pengon fillimin dhe kryerjen e hetimit. Në këtë rast publikimi botohet në numrin e parë të ardhshëm të “Buletinit zyrtar” të Autoritetit.

2. Vendimet e Komisionit, të marra për shkeljen e neneve 4 dhe 9, botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Publikimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përmbajtjen kryesore të vendimit, si dhe gjobat e vëna.

SEKSIONI II

PROCEDURA PËR PËRJASHTIMIN E MARRËVESHJEVE NGA NDALIMI

Neni 48

Përgjegjësitë për dhënien e përjashtimeve

Komisioni është i vetmi organ përgjegjës për të vendosur dhënien e përjashtimeve, të parashikuara në nenet 5, 6 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 49

Njoftimi i marrëveshjeve

1²⁹. Në zbatim të nenit 5 të këtij ligji, ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve njoftojnë në Autoritet marrëveshjet dhe ndryshimet e bëra në to.”.

2. Njoftimi përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) emërtimin e ndërmarrjeve dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike

²⁹ Pika “1” e nenit 49 ndryshuar me nenin 20 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte: “Në zbatim të neneve 5, 6 e 7 të këtij ligji, marrëveshjet horizontale, marrëveshjet vertikale, marrëveshjet e licencës dhe ndryshimet e bëra në to i njoftohen Autoritetit”.

ose vendin e regjistrimit të ndërmarrjeve pjesëmarrëse;

b) llojin e veprimtarisë ekonomike;

c) formën, përmbajtjen dhe objektin e marrëveshjes;

ç) pjesët e tregut përkatës që zënë ndërmarrjet, duke treguar metodologjinë për llogaritjen dhe vlerësimin e tyre;

d) personin e autorizuar që përfaqëson ndërmarrjen gjatë procedurës.

³⁰. Njoftimi i dhënë Autoritetit, sipas kërkesës së pikave 1 e 2 të këtij neni, nuk duhet të përmbajë të dhëna të pasakta, të cilat bëhen shkak për të siguruar përjashtimin për palën njoftuese ose për një palë të tretë, sipas nenit 5 të këtij ligji.

³¹. Ky nen nuk zbatohet për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve, të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 50³²

Vendimi për përjashtime individuale

1. Marrëveshjet e njoftuara në bazë të nenit 49 të këtij ligji përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 5 vetëm me vendim të komisionit.

2. Efektet e përjashtimit fillojnë nga data e njoftimit. Përjashtimet, sipas nenit 5 të këtij ligji, janë të kufizuara në kohë dhe mund t'u jepen ndërmarrjeve me kushte dhe detyrime.

3. Nëse me vendim të komisionit refuzohet përjashtimi nga ndalimi, komisioni nuk mund të vendosë gjoba për shkeljet e shkaktuara nga kjo marrëveshje, për periudhën gjatë së cilës ajo shqyrtohet. Komisioni i konkurrencës nuk mund të vendosë gjoba për ato ndërmarrje, të cilat kanë njoftuar marrëveshjen për periudhën nga data e njoftimit deri në marrjen e vendimit mbi përjashtimin ose jo të zbatimit të nenit 5 të këtij ligji.

4. Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarojnë pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe pranohet brenda 3 muajve para mbarimit të afatit të përjashtimit.

³⁰ Pika "3" ndryshuar me nenin 20 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: "Njoftimi i dhënë Autoritetit, sipas kërkesës së pikave 1 dhe 2 të këtij neni, nuk duhet të përmbajë të dhëna të pasakta, të cilat bëhen shkak për të siguruar përjashtimin për palën njoftuese ose për një palë të tretë, sipas neneve 5 dhe 6 të këtij ligji, ose moskundërshtimin në rastin e nenit 7 të këtij ligji. Autoriteti nxjerr udhëzim për formën e njoftimit"

³¹ Pika "4" e nenit 49, shtuar me nenin 20 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

³² Neni 50, ndryshuar në titull dhe përmbajtje me nenin 21 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Vendimi për përjashtim

1. Llojet e marrëveshjeve të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të këtij ligji përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4, vetëm me vendim të Komisionit. Përjashtimet sipas nenit 7 kanë efekt, nëse Autoriteti nuk do t'i kundërshtojë ato me një vendim, brenda një periudhe tremujore nga marrja e njoftimit.

2. Efektet e përjashtimit fillojnë që nga data e njoftimit. Përjashtimet, sipas neneve 5, 6 dhe 7 të këtij ligji, janë të kufizuara në kohë dhe mund t'u jepen ndërmarrjeve me kushte dhe detyrime.

3. Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e neneve 5, 6 dhe 7 të këtij ligji vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarojnë pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe pranohet vetëm 3 muaj para mbarimit të afatit të përjashtimit.

5. Ky nen nuk zbatohet për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 51
Revokimi i përjashtimit

1. Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e tij, duke vendosur kushte ose detyrime, kur:

a) njëri ose disa nga faktet, që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;

b) palët shkelin një ose disa detyrime, të cilat parashikohen në vendim;

c) vendimi është bazuar në të dhëna të pasakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit;

ç) palët abuzojnë me përjashtimin e dhënë.

2. Vendimi i përjashtimit mund të revokohet me efekt prapaveprues për rastet e pikës 1 shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni.

Neni 52
Botimi i njoftimeve dhe vendimeve për përjashtim

1. Kërkesat për përjashtim botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Njoftimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, një përshkrim të shkurtër të marrëveshjes dhe afatin, brenda të cilit, palë të treta mund të shprehin mendimin e tyre.

2. Vendimet e Komisionit, të marra në mbështetje të neneve 5 dhe 6³³ të këtij ligji, botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Njoftimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe përmbajtjen kryesore të vendimit.

³³ Me nenin 22 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 06. 2010, fjalët “nenet 5, 6 dhe 7” janë zëvendësuar me fjalët “nenet 5 dhe 6”.

KREU IV
PROCEDURAT PËR KONTROLLIN E PËRQENDRIMEVE

Neni 53³⁴

Detyrimi për njoftim

1. Kanë detyrimin për njoftim:
 - a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim;
 - b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera;
 - c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.
2. Njoftimi që paraqet formën e përqendrimit kryhet në bazë të udhëzimit të nxjerrë nga Autoriteti për formën e njoftimit.

Neni 54

Konfirmimi i marrjes së njoftimit

Autoriteti u jep ndërmarrjeve njoftuese një vërtetim me shkrim për marrjen e njoftimit, ku u bën të ditur se njoftimi është i plotë. Kur njoftimi nuk është i plotë, Autoriteti i njofton ndërmarrjet që, brenda një afati, ta plotësojnë atë.

Neni 55

Të dhënat dhe dokumentet plotësuese

1. Ndërmarrjet pjesëmarrëse, ato që bëjnë pjesë në një grup, sipas nenit 16 të këtij ligji dhe ndërmarrjet që shesin një pjesëmarrje ose pjesë ndërmarrjeje, edhe nëse atyre u është dërguar vërtetimi, që konfirmon marrjen e njoftimit të plotë, detyrohen t'i sigurojnë Autoritetit, brenda një afati të caktuar prej tij, të dhënat dhe dokumentet shtesë, që janë

³⁴ Neni 53, ndryshuar në përmbajtje dhe titull me nenin 23 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte:

Detyrimi për njoftim

1. Kanë detyrimin për njoftim:
 - a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim;
 - b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera.
2. Njoftimi paraqet formën e përqendrimit dhe përmban, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse, të dhënat e mëposhtme:
 - a) emërtimin e ndërmarrjes dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike ose vendin e regjistrimit të ndërmarrjes;
 - b) llojin e veprimtarisë ekonomike;
 - c) xhiron në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar;
 - ç) pjesët e tregut përkatës që zënë ndërmarrjet, duke treguar metodologjinë për llogaritjen dhe vlerësimin e tyre;
 - d) madhësinë e pjesëmarrjes së përfuar në çdo ndërmarrje nga blerja dhe totalin e pjesëmarrjes në këtë ndërmarrje, në rastin e blerjes së aksioneve të një ndërmarrjeje tjetër;
 - dh) personin e autorizuar për të përfaqësuar ndërmarrjen gjatë procedurës.
3. Autoriteti nxjerr udhëzim për formën e njoftimit dhe për mundësinë për njoftim të thjeshtuar.

me interes për vlerësimin e përqendrimit.

2. Autoriteti mund të sigurojë nga ndërmarrje të tjera të dhëna dhe dokumente shtesë që janë me interes për vlerësimin e përqendrimit dhe mund t'i njoftojë ato për përqendrimin në fjalë, duke ruajtur sekretin tregtar të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, atyre që bëjnë pjesë në një grup, sipas nenit 16 të këtij ligji, si dhe të ndërmarrjeve që shesin një pjesëmarrje ose pjesë ndërmarrjeje.

³⁵. Nenet 33, 35 e 36 të këtij ligji zbatohen në veprimtaritë e Autoritetit, të parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni

Neni 56

Procedura paraprake

¹³⁶. Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, komisioni vendos të autorizojë përqendrimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

Nëse konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të tilla, komisioni vendos:

- a) autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime;
- b) fillimin e procedurës së thelluar.”.

Nëse konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të tilla, Komisioni vendos fillimin e procedurës së thelluar ose autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime.

2. Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni shtyhet me dy javë, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese³⁷. Angazhimet e propozuara nga palët paraqiten pranë Autoritetit jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së njoftimit.

3. Mungesa e komunikimit brenda këtyre afateve konsiderohet si vendim, që autorizon përqendrimin dhe mund të realizohet pa rezerva.

Neni 57

Procedura e thelluar

1. Komisioni vendos të ndalojë ose jo përqendrimin brenda një periudhe prej tre muajsh nga fillimi i procedurës së thelluar.

2. Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni shtyhet me 2 muaj, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës

³⁵ Pika “3” e nenit 55 të këtij ligji, shtuar me nenin 24 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

³⁶ Pika “1” e nenit 56 ndryshuar me nenin 25 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: “Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese, Komisioni vendos të autorizojë përqendrimin, brenda dy muajve nga data e marrjes së njoftimit.”.

³⁷ Fjalja e parë e pikës “2” të nenit 56, është ndryshuar me nenin 25 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: “Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, afati, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shtyhet me dy javë, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e shenjave të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese”.

dominuose.³⁸ Angazhimet e propozuara nga palët i paraqiten Autoritetit jo më vonë se dy muaj nga data e fillimit të procedurës së thelluar.

3. Mungesa e komunikimit brenda këtyre afateve konsiderohet si vendim, që autorizon përqendrimin dhe realizohet pa rezerva, me përjashtim të rasteve kur:

- a) afati shtyhet nga Komisioni, me pëlqimin e ndërmarrjeve njoftuese;
- b) afati shtyhet me kërkesën e ndërmarrjeve njoftuese;
- c)³⁹.

Neni 57/1⁴⁰

Pezullimi i afateve

Afatet e parashikuara në nenet 56 e 57 pezullohen nga komisioni, me vendim, nëse kjo procedurë e thelluar është penguar nga ndërmarrjet pjesëmarrëse.

Neni 58

Afatet

1. Afati dymujor për fillimin e procedurës paraprake, sipas nenit 56 të këtij ligji, fillon të nesërmen e datës së njoftimit të plotë të përqendrimit. Afati tremujor, sipas nenit 57 pika 1 të këtij ligji, fillon të nesërmen e datës së marrjes së vendimit për të filluar procedurën e thelluar.

2. Kur afati është caktuar në javë, ai mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit që ka të njëjtin emër me atë të ditës që ka filluar afati dhe kur afati është caktuar në muaj, me kalimin e asaj dite të muajit të fundit që ka të njëjtin numër me atë të ditës që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron në ditën e fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën pasardhëse të punës.

Neni 59

Procedura në mungesë njoftimi

Nëse përqendrimi i ndërmarrjeve kryhet pa bërë njoftimin, Komisioni, pasi vëren shkelje në detyrimin për njoftim, fillon, me nismën e vet, procedurat e përcaktuara në këtë kre. Afati, i përcaktuar në nenin 56 të këtij ligji, fillon kur Komisioni ka të dhënat e plota që duhet të përmbajë njoftimi i përqendrimit.

³⁸ Fjalja e parë e pikës “2” të nenit 57, ndryshuar me nenin 26 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: “Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, afati, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shtyhet me një muaj, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.”.

³⁹ Shkronja “c” e pikës “3” të nenit 57, shfuqizuar me nenin 26 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: “afati pezullohet nga Komisioni, i cili, me vendim, shprehet se është penguar në kryerjen e procedurës së thelluar, për shkak të ndërmarrjeve pjesëmarrëse”.

⁴⁰ Neni 57/1 shtuar me nenin 27 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

Neni 60

Autorizimi për përqendrimin e përkohshëm

1. Komisioni, në bazë të një kërkesë nga ndërmarrjet pjesëmarrëse dhe në çdo kohë të procedurës, mund të japë një autorizim për realizim të përkohshëm të përqendrimit, i cili çliron ndërmarrjet nga detyrimet ose ndalimet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji. Ky autorizim jepet nëse ekzistojnë arsye të rëndësishme, në veçanti për të ndaluar dëmet e rënda dhe të pariparueshme të ndërmarrjet pjesëmarrëse ose të palët e treta dhe duke vlerësuar rrezikun që paraqet përqendrimi për konkurrencën.

2. Në autorizimin për realizim të përkohshëm mund të përcaktohen kushtet dhe detyrimet për sigurimin e një konkurrence efektive.

Neni 61

Kushtet dhe detyrimet

1. Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime, në mënyrë përpjesëtimore me pasojat antikonkurrese të përqendrimit, kushtet dhe detyrimet mund të përfshijnë veçanërisht:

- a) shitjen e pjesëve të ndërmarrjeve;
- b) shitjen e çdo lloj pjesëmarrjeje mbi veprimtarinë e një ndërmarrjeje;
- c) ndërprerjen ose lidhjen e marrëdhënieve kontraktore;
- ç) dhënien e licencave;
- d) detyrimin për të vepruar ose për të mos vepruar në një mënyrë të caktuar;
- dh) çdo masë që bën të mundur eliminimin e pasojave antikonkurrese;
- e) çdo masë që bën të mundur zbatimin, në mënyrë korrekte, të kushteve dhe detyrimeve.

2. Autoriteti bën të mundur pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në procesin e përcaktimit të kushteve dhe detyrimeve.

Neni 62

Rivendosja e konkurrencës

1. Në rastin e realizimit të një përqendrimi, para ose pas ndalimit të tij dhe në rastin e realizimit të një përqendrimi pa kryer dhe pa plotësuar kushtet që bashkëlidhen në vendimin e autorizimit të dhënë, sipas neneve 56 dhe 57 të këtij ligji, Komisioni detyron ndërmarrjet pjesëmarrëse që të marrin masat e nevojshme për rivendosjen e menjëhershme të situatës së mëparshme, veçanërisht që të kryejnë ndarjen e ndërmarrjeve të bashkuara ose heqjen dorë nga pjesëmarrjet ose aktivet e përfutuara.

2. Komisioni mund t'u kërkojë ndërmarrjeve pjesëmarrëse të bëjnë propozime për rivendosjen e konkurrencës efektive, duke u përcaktuar atyre afatin përfundimtar për realizimin e këtyre propozimeve. Nëse Komisioni pranon masat e propozuara, ai përcakton afatin kohor dhe mënyrën e zbatimit të këtyre masave nga ndërmarrjet pjesëmarrëse.

3. Nëse ndërmarrjet nuk marrin masat e nevojshme ose Komisioni ka marrë propozime nga ndërmarrjet, por i refuzon ato, ai, me vendim, urdhëron çdo masë të nevojshme për rivendosjen e situatës së mëparshme. Në veçanti, Komisioni mund të

marrë masa të përkohshme për moskufizimin e konkurrencës efektive.

Neni 63
Revokimi

Komisioni mund ta revokojë vendimin nëse:

- a) është marrë në bazë të të dhënave jo të sakta të ndërmarrjeve pjesëmarrëse;
- b) është marrë me anë të mashtrimit;
- c) ndërmarrjet pjesëmarrëse shkelin një ose disa detyrime të parashikuara në autorizim.

Neni 64
Botimi i njoftimit dhe i fillimit të procedurës së thelluar

1. Njoftimi i një përqendrimi dhe vendimi për fillimin e një procedure të thelluar botohen në "Buletinin zyrtar" të Autoritetit. Mungesa e botimit nuk pengon fillimin e afateve dhe të procedurës së thelluar.

2. Njoftimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, një përshkrim të shkurtër të përqendrimit dhe afatin brenda të cilit palë të treta mund të shprehin mendimin e tyre. Mendimet e palëve të treta jepen me shkrim.

3. Vendimet e Komisionit botohen në "Buletinin zyrtar" të Autoritetit. Botimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, përmbajtjen kryesore të vendimit, si dhe gjobat e vëna.

PJESA IV
PROCEDURAT CIVILE

Neni 65
Paditë kundër kufizimeve të konkurrencës

1. Personi që pengohet në veprimtarinë e vet nga një marrëveshje e ndaluar, sipas nenit 4 të këtij ligji, ose nga një praktikë abuzive, sipas nenit 9 të këtij ligji, mund të ngrejë padi në Gjykatën e Tiranës dhe të pretendojë:

- a) eliminimin ose parandalimin e kufizimit të konkurrencës, që rrezikon të kryhet ose që është kryer në kundërshtim me këto nene;
- b) shpërblimin ose pagesën për dëmin e shkaktuar, sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

2. Padia mund të ngrihet pavarësisht nga një procedurë e filluar pranë Autoritetit.

3. Nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kërkesat për përjashtim nga një marrëveshje e ndaluar dhe procedurat e kontrollit të përqendrimeve.

Neni 66
Ushtrimi i padive

1. Gjykata e Tiranës, me kërkesën e paditësve, për të eliminuar ose parandaluar pengesat mund të vendosë, në mënyrë të veçantë, që:

a) kontratat janë tërësisht ose pjesërisht të pavlefshme, me fuqi prapavepruese;
b) ndërmarrja, që shkakton pengesën, ka të drejtë të kontraktojë me ndërmarrjen e penguar, sipas kushteve të zakonshme tregtare.

2. Gjykata e Tiranës i dërgon Autoritetit kopjet e çdo vendimi të gjykuar, në zbatim të ligjit, brenda 1 muaji nga data e dhënies së vendimit.

Neni 67

Masa të përkohshme

Në raste urgjence të justifikuar nga rreziku i shkaktimit të një dëmi të rëndë e të pariparueshëm për paditësin dhe kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të këtij ligji, me kërkesë të paditësit, Gjykata e Tiranës mund të marrë vendime për marrjen e masave të përkohshme.

Neni 68

Juridiksioni

1. Paditë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, ngrihen në Gjykatën e Tiranës.
2. Në rastet kur pala e paditur kërkon pranë Autoritetit përjashtimin e marrëveshjes nga ndalimi, gjykata pezullon procedurën dhe pret vendimin e Komisionit.

PJESA V

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 69

Detyrimi për organet e administratës qendrore dhe vendore

1. Organet e administratës qendrore dhe vendore kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt aktnormativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me:

a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

2. Autoriteti vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projektaktet, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 70

Roli i Autoritetit për rregullimin dhe reformën rregullatore

1. Autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

2. Autoriteti, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në

këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse.

3. Autoriteti, për zbatimin e këtij ligji në sektorët e rregulluar, bashkëpunon me entet dhe institucionet e tjera rregullatore.

Neni 71

Këmbimi i të dhënave me autoritetet simotra

1. Autoriteti, brenda përgjegjësi të veta, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe në bazë të një kërkesë, mund t'i japë të dhëna ose dokumente që zotëron a siguron strukturës përkatëse në Komisionin Europian ose autoriteteve të huaja simotra, në përputhje me legjislacionin shqiptar, duke ruajtur reciprocitetin dhe me kusht që këto autoritete të respektojnë rregullat e sekretit tregtar me të njëjtat garanci si në Shqipëri.

2. Autoriteti mund të kryejë hetime, me kërkesë të autoriteteve të huaja simotra, me kusht ruajtjen e reciprocitetit.

3. Nëse kërkesa e autoriteteve të huaja simotra për ndihmë në kryerjen e hetimeve ose transferimin e të dhënave të zotëruara ose të siguruara nga Autoriteti, rrezikon pavarësinë, sigurinë, interesat themelore ekonomike ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë, pranimi i saj do të refuzohet.

Neni 72

Pezullimi ose mbyllja e procedurave

Kur Autoriteti dhe autoritetet e huaja simotra, të cilat kanë lidhur marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet tyre, kanë pranuar një ankesë ose kanë vepruar me nismën e tyre, në mbështetje të ligjeve përkatëse të konkurrencës për të njëjtën shkelje, fakti që një nga autoritetet është marrë me çështjen, mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për të tjerët, për pezullimin e procesit ose për refuzimin e ankesës.

PJESA VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET

Neni 73

Masa e gjobës për shkeljet e lehta

1. Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse:

a)⁴¹ japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në përgjigje të kërkesës ose vendimit të komisionit, sipas nenit 33 pikat 2 e 3 të këtij ligji, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e komisionit apo në kërkesën e sekretariatit, sipas nenit 33 pika 3 të këtij ligji;

⁴¹ Gërma "a" e pikës "1" të nenit 73, ndryshuar me nenin 28 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte: "japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese në përgjigje të kërkesës ose vendimit të bërë, sipas nenit 33 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e marrë, sipas neneve 33 pika 2 dhe 41 të këtij ligji;

b)⁴² japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;

c) japin të paplotë librat e kërkuar ose regjistrat e tjerë të veprimtarisë së tyre ekonomike, gjatë inspektimeve, sipas nenit 36 shkronjat "b" dhe "c" të këtij ligji, ose refuzojnë të pranojnë inspektimet në mbështetje të vendimit të marrë, sipas neneve 35 pika 1 dhe 36 shkronja "a" të këtij ligji;

ç)⁴³ refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve për faktet dhe, sipas shkronjës "d" të nenit 36 të këtij ligji, japin përgjigje të pasakta, të paplota, të rreme ose pengojnë inspektimin e parashikuar në nenin 36;

d) heqin vulat e vëna në autorizimin zyrtar të Autoritetit, sipas nenit 36 shkronja "ç" të këtij ligji.

dh)⁴⁴ nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji.

2. Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17 zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale.

Neni 74

Masa e gjobës për shkelje të rënda

1⁴⁵. Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që:

a) shkel nenet 4 e 9 të këtij ligji;

b) nuk zbaton vendimin për marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44;

c) nuk përmbush kushtet dhe detyrimet në mbështetje të një vendimi të marrë, sipas neneve 45, 50 pika 2, 56, 57 dhe 60 pika 2 të këtij ligji;

ç)⁴⁶

d) realizon një përqendrim *i cili ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg*⁴⁷, duke mos respektuar detyrimin e nenit 14, përveç rastit kur realizimi i përqendrimit është autorizuar shprehimisht, sipas nenit 60 të këtij ligji;

dh) realizon një përqendrim të ndaluar nga Komisioni ose nuk merr masat e nevojshme për rivendosjen e konkurrencës, sipas nenit 62 të këtij ligji.

2.⁴⁸.

⁴² Gërma "b" e pikës "1" të nenit 73, ndryshuar me nenin 28 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: "japin të dhëna jo të sakta, jo të plota ose mashtruese në njoftimet, sipas neneve 12 dhe 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji"

⁴³ Gërma "ç", e pikës "1" të nenit 73, ndryshuar me nenin 28 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte: "refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve për faktet dhe, sipas nenit 36 shkronja "d" të këtij ligji, japin përgjigje jo të sakta, jo të plota, mashtruese ose pengojnë inspektimin e parashikuar në nenin 36"

⁴⁴ Shkronja "dh" e pikës 1" të nenit 73, shtuar me nenin 28 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09.2010.

⁴⁵ Fjalja e kësaj pike, ndryshuar me nenin 29 të Ligjit Nr. 10317 datë 16. 09. 2010. Ishte: "Komisioni vendos gjoba në masën 2 deri në 10 për qind të xhiros totale të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që."

⁴⁶ Shkronja "ç" e pikës 1 shfuqizuar me nenin 29 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte: "nuk njofton një përqendrim sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji".

⁴⁷ Shprehja me të pjerrët "i cili ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg" shtuar me nenin 29 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010.

⁴⁸ Pika "2" e nenit 74, shfuqizuar me nenin 29 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte: "Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17 zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale"

Neni 75
Përcaktimi i gjobës

1. Për përcaktimin e masës së gjobës merren parasysh rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes. Fitimi i paligjshëm i ndërmarrjeve në sajë të shkeljeve të këtij ligji, përbën masën minimale të gjobës, kur është e mundur të llogaritet ose të vlerësohet në mënyrë objektive.

2. Nëse gjoba vihet ndaj grupimit të ndërmarrjeve, sipas këtij ligji, gjoba nuk mund të kalojë 1 për qind, në rastet e xhiros totale të vitit financiar paraardhës, të përcaktuar në nenin 73 të këtij ligji, ose 10 për qind, në rastet e xhiros totale të vitit financiar paraardhës, të përcaktuar në nenin 74 të këtij ligji, të çdo anëtari të grupimit aktiv në tregun përkatës, të prekur nga shkelja e grupimit të ndërmarrjeve.

Kur grupimi i ndërmarrjeve s'ka fuqi paguese, Autoriteti mund të kërkojë shlyerjen e gjobës nga çdo ndërmarrje, e cila ishte anëtare e grupimit në kohën e kryerjes së shkeljes.⁴⁹ Shuma e paguar nga çdo ndërmarrje anëtare më vete nuk mund të jetë më shumë se 1 për qind në rastin e xhiros totale të kësaj ndërmarrjeje në vitin financiar paraardhës, sipas nenit 73 të këtij ligji, dhe 10 për qind në rastin e xhiros totale të vitit financiar paraardhës të këtyre ndërmarrjeve, sipas nenit 74 të këtij ligji.

Neni 76
Gjobat periodike

1. Komisioni, në bazë të një vendimi, vendos mbi ndërmarrjet gjoba në pagesa periodike ditore jo më shumë se 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së vendimit, në mënyrë që ato:

a) të ndërpresin shkeljet e neneve 4 dhe 9, në përputhje me vendimin e marrë, sipas nenit 45 të këtij ligji;

b) të veprojnë në përputhje me vendimin për marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44 të këtij ligji;

c) të veprojnë në përputhje me detyrimet në mbështetje të vendimit, sipas neneve 45, 50 pika 2, neneve 56, 57 dhe 60 pika 2 të këtij ligji;

ç) të japin të dhëna të plota dhe të sakta, të cilat Komisioni i ka kërkuar, sipas vendimit të parashikuar në nenin 33 pika 2 të këtij ligji;

d) të lejojnë një inspektim, i cili është urdhëruar në bazë të një vendimi, sipas nenit 35⁵⁰ të këtij ligji;

dh) të përmbushin angazhimin për marrjen e masave të nevojshme për rivendosjen e konkurrencës, sipas nenit 62 të këtij ligji.

2. Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17 zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale.

3. Kur ndërmarrjet plotësojnë detyrimin për të cilin është vendosur një gjobë periodike, Autoriteti mund të përcaktojë një shumë përfundimtare të pagesës periodike të

⁴⁹ Pika 2 e fjalisë 2 të nenit 75 është rregulluar me nenin 30 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010.

⁵⁰ Në pikën "1" gërma "d" të nenit 76, fjalët "sipas nenit 36" zëvendësohen me fjalët "sipas nenit 35". Kjo sipas nenit 31 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010

gjobës, më të ulët sesa ajo që do të ishte në mbështetje të vendimit fillestar. Parashikimet e nenit 75 pika 2 të këtij ligji zbatohen edhe për këtë pikë.

Neni 77

Lehtësimi nga gjobat

1. Një ndërmarrjeje, të përfshirë bashkë me të tjerat në një marrëveshje të ndaluar, sipas nenit 4, mund t'i jepet lehtësimi, i plotë ose i pjesshëm, nga gjobat, nëse ajo ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së ndaluar, si dhe në përcaktimin e personave përgjegjës, duke siguruar të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti.

2. Komisioni u jep ndërmarrjeve këshillë për lehtësim nga gjobat, duke treguar edhe kushtet për zbatimin e saj, të përcaktuara në “Rregulloren për gjobat dhe lehtësimin e tyre”. Kjo këshillë u transmetohet ndërmarrjeve dhe nuk publikohet.

3. Në rastin e një vendimi, Komisioni mund të japë lehtësim nga gjobat në përpjesëtim me kontributin e dhënë për zbardhjen, zbulimin dhe ndalimin e shkeljes, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në këshillën për lehtësim.

Neni 78

Sanksione individuale

1. Komisioni vendos gjoba në masën deri në 5 milionë lekë mbi individët, që, me dashje ose nga pakujdesia, kryejnë ose bashkëpunojnë në veprimet e sanksionuara në nenet 73 pika 1⁵¹ dhe 75 pika 1 të këtij ligji.

2. Vendosja e gjobave, sipas pikës 1 të këtij neni, u nënshtrohet afateve të parashkrimit prej tre vjetësh, në rastin e përcaktuar në nenin 73 pika 1⁵² të këtij ligji dhe prej 5 vjetësh, në rastin e përcaktuar në nenin 74 pika 1⁵³ të këtij ligji.

Neni 79⁵⁴

Ankimi

1. Kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

2. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

⁵¹ Në nenin 78, fjalët “73 pika 1” kanë zëvendësuar fjalët “74 pika 1”. Kjo, sipas nenit 32 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

⁵² Shif footonote 48.

⁵³ Në nenin 78, fjalët “nenin 74 pika 1” kanë zëvendësuar fjalët “nenit 75 pika 1 e 2”. Kjo, sipas nenit 32 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010.

⁵⁴ Përmbajtja e nenit 79 ndryshuar në përmbajtje e titull me nenin 33 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010. Ishte:

Ankimi

Kundër vendimeve të Komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankimi në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

Neni 80⁵⁵

Gjoha e vënë nga Autoriteti i Konkurrencës është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Civile. Autoriteti i Konkurrencës nuk ka detyrim që të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.

PJESA VII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 81

Detyrimi i Kuvendit për zgjedhjen e Komisionit

Brenda datës 30 nëntor 2003 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ngarkohet të zgjedhë pesë anëtarët e Komisionit dhe të emërojë Kryetarin e tij.

Neni 82

Vlerësimi i akteve normative në fuqi

1. Autoriteti vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës, të akteve normative në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në mënyrë të veçantë, të projektakteve të parashikuara në nenin 69 pika 1.

2. Autoriteti, pas dy vjetëve dhe pas këshillimit me organet shtetërore përkatëse, harton një raport të veçantë për problemet që ngrihen nga këto akte e lidhur me kufizimin e konkurrencës, të shoqëruar me rekomandimet për ndryshimet e duhura, të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit.

Neni 83

Dispozita kalimtare

1. Për përjashtimin nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të këtij ligji, marrëveshjet ekzistuese, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet t'i njoftohen Autoritetit brenda 9 muajve.

Përjashtimi në këto raste jepet që nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ky ligj nuk zbatohet në rastet e përqendrimeve të ndërmarrjeve, kur ato realizohen brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe kur marrëveshja, për bashkim ose për përfitim kontrolli, si dhe shpallja e ofertës publike, për blerje ose shkëmbim, janë bërë para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për këto përqendrime zbatohet ligji nr. 8044, datë 7.12.1995 "Për konkurrencën".

3. Në qoftë se marrëveshja që kufizon konkurrencën ose praktikat abuzuese me pozitën dominuese njoftohen dhe pasojat mbi konkurrencën eliminohen brenda 6 muajve

⁵⁵ Neni 80 ndryshuar në titull dhe përmbajtje me nenin 34 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16. 09. 2010. Ishte:

Organi i ngarkuar për ekzekutimin e gjobës

Organi i ngarkuar nga ky ligj për ekzekutimin e gjobës është Policia Tatimore.

nga hyrja në fuqi e këtij ligji, sanksionet e parashikuara nga ky ligj nuk zbatohen.

Neni 84
Nxjerrja e akteve

Ngarkohet Autoriteti të nxjerrë aktet e mëposhtme:

- a) Rregulloren e Funksionimit të Autoritetit;
- b) Rregulloren për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës;
- c) Rregulloren për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve;
- ç) Rregulloren për gjobat dhe lehtësimin prej tyre.

Neni 84/1⁵⁶

Çështjet, procedurat hetimore dhe kontrollet e përqendrimeve, pavarësisht nga faza në të cilën ndodhen në çastin e hyrjes në fuqi të dispozitave të këtij ligji, do të vazhdojnë t'u nënshtrohen dispozitave të mëparshme deri në dhënien e vendimit përfundimtar të Komisionit të Konkurrencës.

Neni 84/2⁵⁷

Aktet e Autoritetit të Konkurrencës, të kundërshtuara në gjykatë, do të vazhdojnë të gjykohen, duke u bazuar në ligjin dhe në aktet nënligjore që kanë qenë në fuqi në çastin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Neni 85
Shfuqizime

Ligji nr. 8044, datë 7.12.1995 "Për konkurrencën", shfuqizohet në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 86

Ky ligj hyn në fuqi më 1 dhjetor 2003.

**Shpallur me dekret nr. 3927, datë 14.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

⁵⁶ Neni 84/1 shtuar me nenin 35 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010.

⁵⁷ Neni 84/2 shtuar me nenin 35 të Ligjit Nr. 10 317 datë 16.09.2010.

